

SHOQERIA TREGTARE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “ATSH KAFE 23”
TIRANE

AKT THEMELIMI

Ne Tirane, sot me daten 17.11.2023 (dymije e njezetetre), shtetasi :

Erblin Boletini, lindur me 07.07.2003 Tirane, banues ne Tirane, Rruga Ibrahim Rugova, Pallati Green Park, Nr. 48, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Leter Njoftimit Nr.037742838, me vullnet të lire e të plote dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, Ne ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, “Per Tregetaret Dhe Shoqerite Tregtare krijon shoqerine tregtare”, me pergjegjesi të kufizuar “ATSH KAFE 23” SH.P.K.

NENI 1.

EMERTIMI

Shoqeria tregtare, formohet nga Ortaku i sipercituar, dhe emertohet “ATSH KAFE 23” SH.P.K., emertimi i se ciles do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2.

SELIA

Selia e shoqerise “ATSH KAFE 23” SH.P.K.. eshte ne Tirane, Lagjja 2, Rruga Norbert Jokl, Nr 1.

NENI 3.

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikes se Shqiperise.

Me vendim të Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, mund të krijohen ose anulohen (ne rast se jane çelur) seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Republikes se Shqiperise.

Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4.

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100 (njqind) leke, formuar dhe nenshkruar nga Ortaku i shoqerise me 1 kuote me 100 (njqind) leke, i depozituar sipas ligjit.

Erblin Boletini zoteron, 100% të kapitalit themeltar = 100 (njqind) leke

Ortaku ka pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme.

Shoqeria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

NENI 5.

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqërisë, bëhet para kërkesës së drejtuar QKR për njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik.

NENI 6.

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është mbi 15 vjet, duke filluar ky afat nga dita e shpalljes së regjistrimit pranë QKR Tiranë, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim QKR për të bërë shenimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

NENI 7.

Shoqeria e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 8.

Shoqeria çel llogari bankare në leke vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortakët dhe administratori i caktuar prej saj, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është çelur llogaria.

NENI 9.

Pjesët e kapitalit themelor, janë lirish të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil dhe atij Tregtar.

Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të transferojnë pjesërisht apo tërësisht kontributet e tyre përfshirë dhe fondet e Kontributet në natyrë.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themelor, duhet të jenë të vertetuara me akt noterial dhe për një gjë të tillë Ortakët duhet të marrin paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqeria dhe të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo tu behen të ditura.

NENI 10.

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare “ATSH KAFE 23 ” SH.P.K. eshte:

“Tregtim artikuj te perzier, ushqimor, industrial, konfeksione, pjekje, bluarje e tregtim kafe me pakice.”

NENI 11.

Ortaket mund të zgjerojne aktivitetin tregtar te shoqerise dhe ne drejtime të tjera, të cilat jane me interes per mbarevajtjen e shoqerise.

NENI 12.

Ortaket mund të zgjerojne shoqerine duke pranuar nje ose me shume ortake të tjere, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me nje shoqeri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashte saj.

NENI 13.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte Organi me i Larte Drejtues dhe Vendimor i shoqerise dhe ai ushtron të gjitha kompetencat qe parashikon ligji “Per Tregtaret Dhe Shoqerite Tregtare”.

Ortaket mund t’ia delegojne kompetencat e tyre nje ose me shume administratoreve të caktuar prej tyre ose dhe nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise, vetem mbi bazen e prokures.

NENI 14.

Adminsitrator i shoqerise “ATSH KAFE 23” SH.P.K. eshte z. Erblin Boletini, me afat 5(pese) vjeçar, me te drejte rizgjedhjeje.

NENI 15.

Ky Akt Themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare, vetem ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera të njejta juridike dhe Ortaket e shoqerise e aprovojne dhe e firmosin si me poshte :

Themeluesi i Shoqerise Tregtare

“ATSH KAFE 23” SH.P.K.

Ortaku

Erblin Boletini



SHOQERIA TREGTARE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ATSH KAFE 23”

STATUT

KREU I:

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

NENI 1.

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Ne Tirane, sot me daten 17.11.2023 (dymije e njezetetre), shtetasi :

Erblin Boletini, lindur me 07.07.2003 Tirane, banues ne Tirane, Rruga Ibrahim Rugova, Pallati Green Park, Nr. 48, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Leter Njoftimit Nr. 037742838, me vullnet të lire e të plote dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, Ne ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, “Per Tregetaret Dhe Shoqerite Tregtare krijon shoqerine tregtare”, me pergjegjesi të kufizuar “ATSH KAFE 23” SH.P.K.”

Shoqeria tregtare eshte e vendase dhe emertohet “ ATSH KAFE 23 ” SH.P.K., emertim i cili do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikes se Shqiperise.

Me vendim të Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mund të krijohen ose anulohen (ne rast se jane çelur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise.

Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 2.

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare “ATSH KAFE 23” SH.P.K. eshte:

“Tregtim artikuj te perzier, ushqimor, industrial, konfeksione, pjekje, bluarje e tregtim kafe me pakice.”

NENI 3.

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit tregtar të shoqerise eshte mbi 15 vjet, duke filluar ky afat nga dita e regjistrimit prane QKR, per njohjen dhe regjistrimin e shoqerise si person juridik.

Me vendim të Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim prane QKR per të bere shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare.

Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit te saj ne QKR dhe pajisjen e saj me NIPT. Ushtrimin e Aktivitetit tregtar e fillon pasi të kete kryer keto procedura.

NENI 4.

Selia e shoqerise “ATSH KAFE 23” SH.P.K.. eshte ne Tirane, Lagjja 2, Rruga Norbert Jokl, Nr 1. Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe ate Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nenligjore specifike per ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarise se saj, mbi bazen e Aktit të Themelimit dhe Statutit të saj dhe normat e se Drejtes Tregtare Nderkombetare.

KREU II

Kapitali i Regjistruar

NENI 5.

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100 (njqind) leke, formuar dhe nenshkruar nga Ortaku me 1 kuote me 100 (njqind) leke i depozituar sipas ligjit.

Erbilin Boletini zoteron 100 % të kapitalit themeltar = 100 (njqind) leke

Ortaket kane pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 6.

Kerkesa per te paguar kuotat dhe terheqja e kuotave te papaguara

1. Administratoret mund t’u kerkojne ortakeve te shoqerise pagesen e kontributeve te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes se njoftimit prej 14 ditesh te plota ne te cilin percaktohet koha dhe vendi i kryerjes se pageses) i paguan shoqerise shumen e kerkuar per kuotat e zoteruara. Njoftimi per pagese mund te parashikojte shlyerjen me keste te kontributeve te papaguara. Personi te cilit i drejtohet njoftimi per pagesen e kontributit do te jete pergjegjes per njoftimet qe i drejtohen atij pavaresisht kalimit te mepasshem te pronesise se kuotave me te cilat lidhet njoftimi per pagese.
2. Zoteruesit e perbashket te nje kuote do te jene pergjegjes bashkerisht dhe ne menyre solidare per shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit te mesiperm.
3. Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, personi pergjegjes per shlyerjen e kontributeve do te paguaj nje interes mbi shumen e papaguar me nje kamate vonese prej 4 % ne vit duke filluar nga dita e parashikuar per pagesen.
4. Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve, pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar., Administratoret mund te njoftojne paraprakisht te pakten katermbedhete dite te plota personin pergjegjes per shlyerjen e kontributeve, duke i

kerkuar pagesen e shumes se pashlyer se bashku me shumate e mundshme shtese te kamatevoneses. Njoftimi do te permbaje vendin ku do te kryhet pagesa dhe deklarimin se ne rast moszbatimi te tij, kuotat te cilave u referohet njoftimi do te anulohen.

5. Nese pagesa nuk kryhet brenda afatit te njoftimit, kuota me te cilin lidhet njoftimi perpara se te kryhet pagesa e kerkuar sipas njoftimit, mund te anulohet me vendim te Administratoreve dhe anulimi do te perfshije te gjithe dividendet ose shumate e tjera te pagueshme ne lidhje me kuotat e anuluar dhe te papaguara deri ne momentin e anulimit.
6. Ne pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund te shitet, rishperndahet ortakeve ose te kalohet sipas afateve dhe menyrave qe Administratoret konsiderojne te pershtateshme.
7. Personi, kuota e te cilit eshte anuluar, humbet cilesine e ortakut ne lidhje me kete kuote, por do te jete pergjegjes ndaj shoqerise per te gjitha kontributet qe do te shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqerise ne daten e anulimit te kuotes se bashku me kamatevonesen e llogaritur per keto kontribute perpara anulimit te kuotes.

NENI 7.

Llojet e Kuotave, te Drejtave dhe Kufizimeve

Ne perputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund te emetohen me te drejtat ose kufizimet e parashikuara ne Vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar (tre te katertat) te votave te ortakeve, ne perputhje me parashikimet e nenit 87 te Ligjit.

NENI 8.

Çertifikatat e Kuotave

Secili ortak ka te drejte te perfitoje nje çertifikate per kuoten e zoteruar prej tij. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje çertifikate per kuotat e zoteruara bashkerisht nga disa persona dhe dorezimi i çertifikates ndaj perfaqesuesit te zoteruesve te perbashket te kuotave do te konsiderohet si dorezim i kryer ndaj te gjithe zoteruesve te kuotave, ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit. Emrat e zoteruesve te perbashket te kuotave do te renditen ne çertifikaten e kuotes. Çertifikata nuk do te gezoje cilesine e letres me vlere.

NENI 9.

Kalimi me Kontrate i Kuotave

Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim dhe sipas formaliteteve te percaktuara nga Administratoret. Kjo kontrate dergohet ne seline e shoqerise.

Administratoret mund te refuzojne regjistrimin e kalimit te kuotes ne QKR ne rast se kjo kuote nuk eshte shlyer plotesisht ose ne rast se Administratoret nuk jane dakort me personin qe i kalon kuota.

Nese Administratoret refuzojne te regjistrojne kalimin e kuotes, ata do te njoftojne per mospranimin personin te cilit i kalon kuota, brenda nje muaji nga data ne te cilen eshte paraqitur ne shoqeri kerkesa per regjistrimin e kalimit te kuotes.

NENI 10.

Kalimi i kuotave me Trashegimi ose si pasoje e Falimentimit

Nese nje ortak vdes, trashegimtari ne rastin e bashkezoterimit te kuotave dhe trashegimtaret e tij ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtar i vetem i bashkezoteruesve te kuotave, do te jene personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues te te drejtave mbi kuoten e tij; pavaresisht parashikimeve te ketij Statuti, pasuria e ortakut te vdekur nuk çlirohet nga pergjegjesis ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me persona te tjere.

Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortaku, pas paraqitjes se provave te kerkuara nga Administratoret, mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjetër te caktuar prej tij si perfitues i kuotes. Nese personi i mesiperem zgjedh te behet zoterues i kuotes, ai njofton shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese ky person zgjedh nje person tjetër te regjistrohet si zoterues i kuotes, ai kalon kuoten ne dobi te personit tjetër.

Personi qe fiton te drejta mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortaku do te kete te drejta qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesemarrjes ose te votes ne çdo Mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne QKR.

NENI 11.

Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar

Asambleja e pergjithshme, me shumice te kualifikuar, mud te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qelim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.

Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar te votave.

NENI 12.

Blerja e kuotave te Veta.

Shoqeria mund te bleje kuotat e veta dhe te kryeje pagesa per blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqerise qe do tu shperndahen ortakeve apo emetimi i kuotave te reja vetem nese shoqeria permbush kushtet per shperndarjen e fitimeve sipas nenit 77 te Ligjit dhe Administratoret leshojne nje çertifikate te aftesise paguese te parashikuar nga ky nen. Ne rast se blerja e kuotave te veta nuk eshte ne perputhje me kushtet e nenit 77 te Ligjit, padite mbi pergjegjesisine e shoqerise mund te ngrihen ne pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 te Ligjit.

KREU III

NENI 13.

Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çshtjet e meposteme:

- a. percaktimin e politikave tregetare te shoqerise.
- b. ndryshimin e statutit.
- c. emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- d. emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabet te autorizuar.
- e. percaktimin e shperblimeve per administratoret, likuiduesve dhe ekspertit kontabel te autorizuar.
- f. mbikqyrjen e politikave tregetare nga administratoret, perfshire dhe pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- g. zmadhimin e zvogelimin e kapitalit.
- h. pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- i. perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera te administratoreve.
- j. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- k. miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Administratoret therrasin Asamblene e Pergjithshme dhe, me kerkesen e ortakeve sipas nenit 84 te Ligjit, do te procedojne me thirrjen e Asamblese se Pergjithshme.

Mbledhje e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi te derguar me poste ose poste elektronike drejtuar çdo ortaku, perfshire edhe perfaqesuesin e kuotave ne zoterim te perbashket, Njoftimi duhet te kryhet te pakten shtate dite te plota perpara dates se caktuar per mbledhjen pervec rasteve kur njoftimi i mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme, i cili permban nje afat me te shkurter eshte miratuar nga shumica e ortakeve te cilet zoterojne jo me pak se nentendhete perqind te vleres nominale te kuotave. Secilit ortak, se bashku me njoftimin per mbledhjen, i dergohet edhe numri PIN per te mundesuar pjesemarrjen dhe votimin elektronik ne mbledhje.

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme jane te pavlefshme ne rast moskryerje te paqellimshme se njoftimit apo mos-marrjes se njoftimit te mbledhjes nga personat, te cilet kane te drejte te marrin kete njoftim, me perjashtim te rastit kur shoqeria provon se personi i ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte.

NENI 14.

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

Mbledhja e zakonshme thirret nje here ne vit.

Ajo thirret nga administratoret apo ortaket.

Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 % te asetëve te shoqerise qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Asambleja e Pergjithshme mblidhet kur i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar.

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme behet nepermjet nje njoftimi me shkrese

Asambleja e Pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorunit te parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen, audio ose audio-video, ne perputhje me nenin 88 te Ligjit. Ortaket qe marrin pjese me njete komunikimi elektronik kane

te drejte te votojne nepermjet nurmit PIN qe iu eshte derguar se bashku me njoftimin per Mbledhjes e Asamblese se Pergjithshme.

Administratoret caktojne Kryetarin e mbledhjes, si dhe nje person per te mbajtur procesverbalin e saj.

Nese asnje prej Administratoreve nuk deshiron te caktohet si Kryetar i Mbledhjes ose nese asnje prej Administratoreve nuk eshte i pranishem per pesembedhjete minuta duke filluar nga ora e caktuar per fillimin e mbledhjes, ortaket e pranishem dhe me te drejte vote zgjedhin njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes.

Administratori pavaresisht se nuk eshte ortak, ka te drejten e pjesemarrjes, si dhe te marre fjalen ne çdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme.

Kryetari me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme ne mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj, (dhe eshte i detyruar nese kerkohet nga Asambleja e Pergjithshme), te shtyje mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato çeshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e meparshme. Kur mbledhja e Asamblese se Pergjithshme shtyhet te pakten shtate dite te plota perpara kesaj date dhe ne te do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi i pergjithshem i rendit te dites. Ne rast te kundert, dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme.

Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votim i fshehte. Votimi i fshehte mund te kerkohet nga:

1. Kryetari, ose
2. Nje ortak ose ortaket qe perfaqesojne te pakten pese perqind te kapitalit themeltar te shoqerise. Kerkesa e bere nga nje perfaqesues i autorizuar i ortakut ka te njejten vlere me kerkesen e paraqitur nga vete ortakut.

Me perjashtim te kundershimit te nje ortakut, deklarimi i Kryetarit se vendimi eshte marre ne menyre unanime, ose me nje shumice te caktuar, nuk eshte miratuar ose nuk eshte miratuar me nje shumice te caktuar dhe regjistrimi perkates ne procesverbalin e mbledhjes perben prove perfundimtare te ketij fakti, pa pasur nevojte per numerimin e votave te regjistruara pro ose kunder vendimit.

Ne rast se ka kundershime per kete deklarate, do te zhvillohet nje votim i fshehte ne lidhje me percaktimin e numrit te votive pro dhe kunder vendimit.

NENI 15.

Votat e Ortakeve

Ne perputhje me te drejttat ose kufizimet qe rrjedhin nga kuotat, çdo kuote i jep ortakut (ne rastin kur eshte individ) te pranishem apo perfaqesuesit te tij te autorizuar ose ortakut (ne rastin kur eshte person juridik), i cili eshte i pranishem permes perfaqesuesit ligjor apo perfaqesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt, te drejten e nje vote.

Ortaket e shoqerise kane dhe keto të drejta dhe detyra kryesore:

Të marrin pjese ne drejtimin dhe administrimin e gjithanshem të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise dhe të çdo veprimtarie tjeter të saj, kur ajo ushtrohet ne perputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

Të kerkojne dhe t'i jepen të gjitha informatat qe kane të bejne me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarise se shoqerise, si dhe i të gjitha dokumentave të perpunuara nga shoqeria, ato qe kane të bjene me nxjerrjen e rezultatit Ekonomik të bilancit kontabel apo per çdo llogari të çelur si dhe të asaj likuiduese dhe asaj rrjedhese.

Të marre pjese ne rezultatet e veprimtarise se Shoqerise ne çfaredo forme apo sasi, sipas kontributit të dhene prej tyre.

Asnje ortak nuk do te votoje ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, ne lidhje me kuoten e zoteruar prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me kete kuote.

Çdo kundershtrim ne kohe per cilesine e nje votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i te cilit do te jete perfundimtar. Te gjitha votat e pakundershtuara ne nje mbledhje te shtyre do te jene te vlefshme.

NENI 16.

Votimi me Prokure

Behet sipas formes qe parashikon legjislacioni ne fuqi dhe i parashikuar njekohesisht edhe nga Ligji.

NENI 17.

Hetimet e Posaçme

Personi ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin apo zevendesimin e nje eksperti te fushes sipas nenit 92 te Ligjit paraqesin nje kerkese te tille nepermjet depozitimit te nje deklarate noteriale ne seline e shoqerise, e cila verteton se personi ose personat plotesojne kushtet per kryerjen e ketij veprimi.

KREU IV

Emerimi i Administratoreve

NENI 18

Asambleja e Pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizike si Administratore te shoqerise per nje periudhe pese vjecare, me te drejte riperteritje. Emerimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga Asambleja e Pergjithshme, i cili, nese miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si Administrator.

Perfaqesimi i shoqerise ne mardheniet me të tretet si brenda dhe jashte shtetit si rregull dhe pergjithesisht i perket Administratorit, i cili eshte z.Erblin Boletini, me afat 5 (pese) vjeçar, me te drejte riperteritje.

NENI 19

Kompetencat e Administratoreve

Politikat tregtare te shoqerise do te administrohen nga Administratoret, te cilet mund te ushtrojne te gjithe kompetencat qe nuk i rezervohen Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 81 te ligjit. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Pergjithshme dhe udhezimet e saj nuk do te shfuqizojne aktet e mepareshme te Administratoreve, te cilat do te ishin te vlefshme nese ndryshimi nuk do te ishte kryer ose udhezimi nuk do te ishte dhene.

Administratoret mund t'ua delegojne kompetencat e tyre çdo komiteti, i cili perbehet nga nje ose me shume Administratore. Çdo delegim kompetencash mund te kryhet ne perputhje me kushtet qe mund te vendosin Administratoret dhe mund te revokohet ose ndryshohet. Administratoret nuk mund te delegojne detyrimet e tyre ligjore.

NENI 20

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratoreve

Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:

1. personi nuk eshte me Administrator sipas parashikimeve te Ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 te nenit 95 te Ligjit qe thote qe administratori mund te shkarkohet ne çdo kohe me shumice te zakonshme.
2. personi ndodhet ne gjendje paftesie paguese.
3. personi vuan ose mund te vuaje nga çrregullime mendore.
4. personi jep doreheqjen duke njoftuar shoqerine, ose
5. ka munguar per me shume se gjashte muaj radhazi pa lejen e Administratoreve te tjere ne mbledhjet e Administratoreve te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe Asambleja e Pergjithshme, me propozimin e Administratoreve, vendos te shkarkoje nga detyra.

NENI 21

Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratoreve

Administratoret shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e 97 te Ligjit: Shperblimit baze te tij mund ti behen shtesa qe mund te jene perqindje ne fitim ose te ngjashme. Shperblimi behet ne perputhje me gjendjen financiare te shoqerise. Nese shoqeria eshte ne gjendje jo te mire financiare atehere ajo mund te vendose edhe reduktimin e shperblimit te tij.

Asambleja e Pergjithshme mund te parashikojte perfitime, nepermjet shperblimeve ne para, pensione, sigurime ose forma te tjera, per çdo person, i cili ka qene, por nuk eshte me ne detyre apo i punesuar ne shoqeri, shoqeri te tjera, te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose per çdo shoqeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filialeve te saj, ose per çdo familjar te tyre (perfshire bashkeshortin/en, ish bashkeshortin/en) oes persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre, mund te paguaje kontribute ne fonde te caktuara per dhenjen e perfitimeve te tyre.

Administratoreve mund t'iu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesemarrjen e tyre ne mbledhjet e Administratoreve ose te Komiteteve te Administratoreve ose te Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre.

NENI 22

Mbledhjet e Administratoreve

Mbledhjet e tyre mbahen sipas nevojave te aktivitetit tregtar e shoqerise.

Vendimet e Mbledhjes se tyre merren me kuorumin e votiae qe mund te percaktohet nga Administratoret, dhe ne rast se ky kuorum nuk eshte percaktuar ai do te jete dy.

Asambleja e Pergjithshme cakton njerin prej Administratoreve ne detyren e Kryetarit te mbledhjes se Administratoreve, i cili mund te shkarkohet ne çdo kohe nga kjo detyre.

Kryetari do te drejtoje çdo mbledhje te Administratoreve ne te cilat ai eshte i pranishem.

Ne rast se Kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen apo nuk eshte i pranishem brenda pese minutave nga ora e caktuar per mbledhjen, Administratoret e pranishem mund te emerojne njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes.

Çeshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votave te pjesmarresve. Ne rast numri te barabarte votash, vota e Kryetarit do te jete vendimtare.

Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratoreve, ose nga nje Komitet i Administratoreve, apo nga persona te cilet veprojne si Administratore, pavaresisht nese behet e ditur me vone se ka patur mangesi ne emerimin e nje Administratori ose njeri prej tyre ka qene i skualifikuar nga mbajtja e kesaj detyre, ose nuk kishin te drejte te votonin, do te konsiderohen te vlefshme njelloj sikur keta persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar e te vazhdonin detyren si Administratore dhe te kishin te drejte te votonin ne mbledhje.

Vendimi me shkrim i nenshkruar nga te gjitha Administratoret qe kane te drejte te njoftohen per mbledhjen e Administratoreve ose nga Komiteti i Administratoreve do te konsiderohet si i vlefshem dhe i efektshem njelloj si te ishte miratuar ne mbledhjen e Administratoreve dhe e zhvilluar rregullisht.

NENI 23

Kufizimet ne Votimet e Administratoreve

Administratoret nuk do te lidhin marreveshje ose votojne ne mbledhjen e Administratoreve per çeshtje ne te cilin keta anetare kane, direkt ose indirekt, nje interes apo detyrim i cili eshte material, qe eshte apo mund te jete ne kundërshtim me interesat e shoqerise, ne pajtim me nenin 13 te Ligjit, deri ne momentin kur ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, te gjithë anetaret kane rene dakort qe:

1. te autorizojne lidhjen e kesaj marreveshje dhe
2. te autorizojne kete anetar qe te votoje ne lidhje me kete çeshtje.

Autorizimi mund te jete i pergjithshem ose i posaçem per nje çeshtje te caktuar. Autorizimi i pergjithshem regjistrohet prane QKR.

Vota e Administratorit nuk do te llogaritet ne kuorumin e pjesemarresve ne mbledhje ne lidhje me vendimin per te cilin ky anetar nuk ka te drejte te votoje. Dispozitat e nenit 89 te Ligjit do te zbatohen lidhur me perjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra ne kete mbledhje.

Ne rast se ne mbledhjen e Administratoreve ose te komitetit te Administratoreve diskutohet nje çeshtje e lidhur me te drejten e votes se nje Administratori, çeshtje mund ti drejtohet Kryetarit te mbledhjes, perpara perfundimit te mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator te ndryshem nga ai vete do te jete perfundimtar dhe i formes se prere.

NENI 24

Procesverbalet e mbledhjes se Administratoreve

Administratoret kujdesen qe ne libra te posaçem te mbahen procesverbalet e:

1. Te gjitha takimeve te kryera nga Administratoret dhe
2. Te gjitha mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme, mbledhjeve te Administratoreve dhe komiteteve te Administratoreve, perfshire edhe emrat e Administratoreve te pranishem ne keto mbledhje.

KREU V

Dividentet dhe Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

NENI 25

Dividentet

Pas plotesimit te parashikimeve te nenit 77 te Ligjit, shoqeria me shumice te kualifikuar te votave te Asamblese se Pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividenteve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me kuotat, te gjitha dividentet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumat e paguara per kuotat per te cilet paguhet dividenti. Te gjitha dividentet pjesetohen dhe paguhen ne perpjestim te drejte me shumat e paguara per kuotat, pjeses ose pjeseve te periudhes per te cilen paguhet dividenti: ne rast se kuota emetohet me kushtin e perfitimit te dividentit nga nje date e caktuar, dividenti do te paguhet ne perputhje me kete kusht.

Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbarte interesa ndaj shoqerise nese nuk parashikohet nga te drejtat qe lidhen me kuoten.

Çdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet brenda dymbedhjete vjeteve nga data e maturimit, ne rast se vendoset me shumice te kualifikuar votash nga Asambleja e Pergjithshme, do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe ta paguaje ate.

NENI 26

Kalimi i Fitimeve ne KapitalinThemeltar

Administratoret pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash dhe duke patur parasysh parimet e percaktuara ne nenin 14 te Ligjit, mund te vendosin te kalojne ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te pagua dividente preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqerise.

KREU VI

Prishja dhe Njoftimet

NENI 27

Ne rast te likuidimit te shoqerise, likiduesi ne perputhje me Ligjin dhe me vendimin e marre me shumicen e kualifikuar te votive te Asamblese se Pergjithshme, mund te shperndaje ne dobi te ortakeve te gjitha ose nje pjese te vleres se pasurive te shoqerise dhe per kete qellim

mund te vleresoje çdo pasuri dhe te percaktoje menyren e shperndarjes midis ortakeve te shoqerise.

NENI 28

Njoftimet

Njoftimet mund te jene me shkrim ose nepermjet komunikimit elektronik ne adresen e parashikuar sipas pikes 3 te nenit 4 te ketij statute dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryen njoftimin.

Shoqeria mund te njoftoje nje ortak personalisht ose duke e derguar njoftimin me leter porosi me kthim pergjigje ne adresen e regjistruar te ortakut ose ne adresen apo ne posten elektronike dhe qe i eshte njoftuar shoqerise nga ortakut. Kur ka disa bashkezoterues te nje kuote, te gjitha njoftimet i jepen perfaqesuesit te tyre te perbashket ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit.

Ky Akt Themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare, vetem ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera të njëjta juridike dhe Ortaket e shoqerise e aprovojne dhe e firmosin si me poshte :

Themeluesi i Shoqerise Tregtare

“ATSH KAFE 23” SH.P.K.

Ortakut

Erbilin Boletini

